



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20 Tetor 2023

Nr: 811

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 1 ID NGA ORGANIZATA “QËNDRESA QYTETARE”, PËR NDALIMIN E AKTIVITETIT TË KANDIDATIT TË “PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023

Sot më datë 20 Tetor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Organizata “Qëndresa Qytetare”

SUBJEKT: Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”
Z. Albert Halilaj, kandidat për kryetar të Bashkisë Kukës

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” për ndalim të aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, z. Albert Halilaj, për shkelje të parashikuara në nenin 78, pika 9, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “n”, neni 78, pika 9, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 20 Tetor 2023

Nr: 811
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nga organizata “Qëndresa Qytetare”, për ndalimin e aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”

KONSTATOJ:

Në datën 19.9.2023, në e-mail-in zyrtar të faqes së denoncimeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar nga Organizata “Qëndresa Qytetare” kërkesë për ndalim të aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, z. Albert Halilaj.

Nëpërmjet vendimit nr. 783 datë 20.9.2023 *“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, për ndalimin e aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, z. Albert Halilaj, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.”* Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve, mori vendimin për pushimin e procesit administrativ ndaj subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe kandidatit të saj, z. Albert Halilaj, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023. Ky vendim i është njoftuar palëve nëpërmjet postës elektronike.

Më datë 20.9.2023, nëpërmjet shkresës administruar nga KQZ me nr. 6942/1, datë 20.9.2023, “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nga sekretari për çështje zgjedhore z. Eridian Salianji është sqaruar se *“Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe kandidati i saj z. Albert Halilaj nuk organizon dhe nuk zhvillon sot koncertin në qytetin e Kukësit”*.

Gjithashtu nëpërmjet postës elektorine, në datë 20.9.2023, z. Albert Halilaj kandidati i “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, për zgjedhjet e pjesshme në Bashkinë Kukës, të datës 24 Shtator 2023 ka sqaruar se nuk do e organizoj dhe zhvilloj koncertin në qytetin e Kukësit.

Më datë 20.9.2023, janë njoftuar të gjitha palët, nëpërmjet postës elektorine për tu bërë pjesë e senacës publike, për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, për ndalimin e aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, z. Albert Halilaj, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës të datës, 24 Shtator 2023. Po nëpërmjet postës elektronike është administruar përgjigja nga z. Eridian Salianji, ku ka sqaruar se “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe kandidati i saj z. Alber Halilaj nuk e organizon dhe zhvillon koncertin në qytetin e Kukësit.

Më datë 20.09.2023, ora 16:30, palët në proces u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të shqyrtimit administrative të denoncimit të Organizatës “Qendra Qëndresa Qytetare”. Në seancë u paraqit z. Dhimitër Zguro në cilësinë e përfaqësuesit të Organizatës Qendra “Qëndresa Qytetare”, ndërsa palët e tjera pjesë e çështjes objekt shqyrtimi nuk u paraqitën për të marrë pjesë në këtë seancë publike dëgjimore.

Z. Zguro, në deklarimet e tij, i qëndroi denoncimit të depozituar më datë 19.09.2023, nëpërmjet së cilit kërkon marrjen e masave të menjëhershme nga KQZ, për ndalimin e koncertit festiv që do të zhvillohet në bashkinë Kukës, më datë 20.09.2023, ora 18:30.

Pas analizës ligjore, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve të administruara dhe pasi u dëgjua denoncuesi në këtë procedurë administrative, vlerësoj se, në kushtet kur subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" dhe kandidati i saj për Kryetar Bashkie, z. Albert Halilaj angazhohen për respektimin e dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor dhe marrjen e masave për mos të zhvilluar aktivitetin e planifikuar, nuk gjendemi para kryerjes së shkeljes administrative, sipas nenit 78, pika 9 të Kodit Zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të monitorojë në vijimësi si do të procedojnë subjektet zgjedhore.

Gjithashtu u kërkuar nga struktura përgjegjëse të njoftohet monitoruesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për bashkinë Kukës, për të monitoruar në terren për kryerjen ose jo të koncertit festiv, dhe të raportojë menjëherë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit të monitorimit.

Nëpërmjet vendimit nr. 783 datë 20.9.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës "Qëndresa Qytetare", për ndalimin e aktivitetit të kandidatit të "Partisë Socialiste të Shqipërisë", z. Albert Halilaj, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023", miratova vendimin për pushimin e procesit administrativ ndaj subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" dhe kandidatit të saj, z. Albert Halilaj, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023. Ky vendim i është njoftuar palëve nëpërmjet postës elektronike.

Në datën 21.9.2023 është administruar shkresa e denoncimit me nr. 6954 prot., datë 21.9.2023, nga Organizata "Qëndresa Qytetare", regjistruar me numër regjistri 01 ID, nëpërmjet së cilës pretendohet se:

"Pas kërkesës nga Organizata "Qëndresa Qytetare", pranë KQZ-së për ndalimin e këtij aktiviteti, KQZ ka kërkuar shpjegime nga ana e Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe kandidati i saj në Bashkinë Kukës. Përfaqësuesi i Partisë Socialiste të Shqipërisë, ka sqaruar se nuk do ta organizoj dhe zhvilloj koncertin në Bashkinë Kukës, të njëjtën gjë ka shprehur dhe kandidati. Deri në orën 3:15 PM të datës 20.9.2023, posterit që propagandonte përmbylljen e fushatës së kandidatit Halilaj dhe organizimin e koncertit ka qenë aktiv. Përpara nisjes së seancës publike para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ky postim është fshirë nga kandidati i Partisë Socialiste dhe personat e tjerë. Në kushtet e mësipërme, kur si kandidati, ashtu edhe Partia Socialiste e Shqipërisë, pranuan se koncerti i parashikuar nuk do të zhvillohej, KQZ vendosi pushimin e kërkesës së Qendrës "Qëndresa Qytetare". Megjithatë, nga rrjetet sociale dhe monitorimi në terren përmes monitoruesve të Qendrës kemi mësuar se koncerti i zhvilluar,

pavarësisht angazhimit me shkrim të Partisë Socialiste dhe z. Albert Halilaj për të mos e zhvilluar atë. Koncerti u zhvilluar”.

Monitoruesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet raportit të monitorimit me Kodin unik nr. 55436203, të datës 21.09.2023, ndër të tjera sqaron se “Më datë 20.09.2023, ora 18:30, kandidati për kryetar bashkie, i subjektit PS, Albert Halilaj, ka zhvilluar takimin përmbyllës të fushatës me banorët e Kukësit.

I pranishën ka qënë dhe z. Pandeli Majko”. Takimi është zhvilluar në sheshin “Skënderbej”, përballë pallatit të kulturës “Hasan Prishtina”, Kukës. Të pranishëm kanë qënë rreth 1000 persona.

Pas këtij takimi është mbajtur dhe një koncert për të pranishmit në këtë takim. Bashkëlidhur raportit janë dërguar dhe disa foto.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë objekt denoncimi.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara. Deri më datë 06.10.2023, datë e cila përkon me zhvillimin e seancës publike për shqyrtimin e rastit objekt denoncime nuk u administrua asnjë përgjigje nga palët në proces hetimi administrativ.

Më datë 06.10.2023, palët në proces janë njoftuar për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike u paraqit përfaqësuesi i Organizatës “Qendra “Qëndresa Qytetare”, i cili në deklaratimet e tij i qëndroi deklaratimeve të depozituara më shkrim, për konstatimin e shkeljes së detyrimeve ligjore të subjekteve zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të bashkisë Kukës, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe z. Albert Halilaj, kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Kukës, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe në mungesë të kërkesës për bashkëpunim nga palët në proces, kërkoja kërkimin e informacionit edhe njëherë nga palët në proces për të vijuar më tej me shqyrtimin në themel të çështjes.

Në vijim të hetimit administrative, nëpërmjet shkresës nr. 6959 prot., datë 21.9.2023, i është kërkuar informacion z. Andrit Shehu, kryetar në detyrë në bashkinë Kukës dhe z. Artan Bajraktari drejtor i Policisë Vendore Kukës, në lidhje me subjektin që ka kërkuar leje për organizimin e këtij takimi dhe të koncertit festiv.

Në përgjigje të shkresës nr. 4126/1 prot., datë 05.10.2023, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me nr. 7152 prot., datë 9.10.2023, me lëndë “*Kthim përgjigje*”, z. Andrit Shehu, me funksion zv. Kryetar për bashkinë Kukës, ndër të tjera sqaron se: *“Koncerti festiv është organizuar nga subjekti “Amerika Grup” sipas kërkesës së bërë nga ana e tyre për dhënien e lejes për zhvillimin e aktivitetit në territorin e Bashkisë Kukës më datë 14.9.2023. Sipas kërkesës koncerti është zhvilluar në ambientet pranë Pallatit të Kulturës “Hasan Prishtina”, konkretisht në shkallët e tij. Leja për zhvillimin e këtij aktiviteti është dhënë për fashën kohore ora 20:00 deri në 23:59 në datën 20.9.2023. Përsa i përket aktivitetit të mbylljes së fushatës ai është zhvilluar në pjesën lindore të Sheshit “Skënderbej” në orën 18:00, në datën 20.9.2023. Për sa më sipër, aktivitetet e zhvilluara në atë ditë nuk janë bërë nga i njëjti subjekt, ato kanë qënë në vende të ndryshme dhe nga organizator të ndryshëm.”* Bashkëlidhur me shkresën na janë vënë në dispozicion materiale të cilat provojnë vërtetësinë e pretenduar nga bashkia Kukës.

Më datë 20.10.2023, palët në proces u njoftuan për zhvillimin e seancës publike për të parashtruar konkluzionet përfundimtare, në seancë u paraqit vetëm përfaqësuesi i Organizatës Qendra “Qëndresa Qytetare”, i cili në dhënien e konkluzioneve përfundimtare parashtroi faktin se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 09, datë 24.12.2020, të cilat duhet të bëjnë më përgjegjësi Subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, si dhe kandidatin për kryetar bashkie për bashkinë Kukës, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 24 Shtator 2023.

Postimi i bërë në rrjetin social “Facebook”, nga kandidati për kryetar bashkie për bashkinë Kamëz, z.Halilaj, rezulton të jetë fshirë po në datë 20.09.2023, datë e cila përkon me hetimin administrative të nisur për denoncimin për ndalimin e zhvillimit të këtij koncerti, ndërsa posteri rezulton të jetë i postuar ende në rrjetin social “Facebook”, të njërit prej artistëve pjesëmarrës në koncert i cili ndër të tjera shkruan ...”Në fushatën përmbyllëse të kandidatit.....”.

Nga kjo provohet fakti se koncerti është zhvilluar dhe organizuar në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe kandidati për kryetar bashkie për bashkinë Kukës.

Në përfundim të hetimit administrativ, nga dokumentacioni i administruar dhe deklaratimet e palëve në këtë proces administrativ provohet se aktivitetet objekt denoncimi janë zhvilluar në ditën e përmbylljes së fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie për bashkinë Kukës.

Duke u bazuar në provat dhe faktet të administruara vlerësoj se koncerti i zhvilluar në sheshin “Skënderbej”, pranë Palltatit të Kulturës “Hasan Prishtina”, është zhvilluar nga subjekti privat “Amerika Grup”, gjithashtu në një zonë të veçuar nga vendi ku do të zhvillohej aktiviteti për mbylljen e fushatës zgjedhore nga kandidati për kryetar për Bashkinë Kukës.

Vlen për t’u theksuar fakti që dy aktivitet janë zhvilluar në një distancë kohore të ndryshme nga njëri tjetri, fakt ky që vërteton se koncerti dhe mbyllja e fushatës janë organizime të ndryshme.

Referuar nenit 78, pika 9, të Kodit Zgjedhor parashikohet se, **“Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet të organizojnë, kryejnë apo mbulojnë shpenzimet vetë ose nëpërmjet të tretëve për koncerte, shfaqje kulturore argëtuese apo veprimtari bamirësie, pavarësisht nëse ato mbahen përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale, apo zhvillohen si veprimtari fushate ose jashtë saj.”** Në zbatim të këtij neni, Komisioni Rregullator ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.12.2020. Çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që ka këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për **mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore.**

Neni 81, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet se **“Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor”**.

Nga vlerësimi literal i dispozitave të sipërcituara provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ ga analiza ligjore, vlerësoj se, në kushtet kur subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe kandidati i saj për Kryetar Bashkie, z. Albert Halilaj kanë zhvilluar veprimtari të ndryshme nga ajo për të cilën pretendon denoncuesi, nuk gjendemi para kryerjes së shkeljes administrative, sipas nenit 78, pika 9 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “n”, nenin 78, pika 9, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes ndaj z. Albert Halilaj, kandidat për kryetar për bashkinë Kukës, porpozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes ndaj subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Kopje: 4

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

I.Horanlliu _____

M.Koja _____

A. Lamçe _____

Y.Merkaj _____

Ilirjan CELIBASHI

Data: 20 Tetor 2023 Nr: 811
Ora: 12:00



Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nga organizata “Qëndresa Qytetare”, për ndalimin e aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.